



VROJTIMI I AKTIVITETIT KREDITUES

2

0

1

9

Tremujori i dytë

DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

HYRJE¹

Pyetësoni i Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues synon të mbledhë opinionin e bankave tregtare lidhur me zhvillimet e tre muajve më të fundit në ofertën dhe kërkesën për kredi, si edhe pritjet e tyre për tremujorin e ardhshëm. Vrojtimi i aktivitetit kreditues jep në mënyrë të përmbledhur perceptimet e bankave mbi ndryshimet në kushtet e ofertës për kredi, ilustruar nëpërmjet standardeve dhe kushteve e termave të kreditimit, si edhe mbi ndryshimet në kërkesën për kredi, si për bizneset ashtu edhe individët. Kjo analizë bazohet në rezultatet e agreguara nga përgjigjet e dhjetë bankave, të cilat zotërojnë peshën më të madhe të stokut të kredisë së dhënë për sektorin privat.

¹ Pyetësoni i Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues është rishikuar në tremujorin e dytë të vitit 2018, me qëllim përfrimin e tij të mëtejshëm me praktikën më të fundit ndërkombëtare, sidomos me atë të Bankës Qendrore Evropiane. Për pasojë, dhe analiza e lidhur me të është përshtatur me pyetësonin e ri. Ajo është pasuruar në terma të pyetjeve shtesë si edhe specifikimeve lidhur me faktorët që ndikojnë standardet, kushtet e kreditimit dhe kërkesën për kredi. Duke filluar nga tremujori i katërt i vitit 2018, seritë janë testuar për praninë e sezonalitetit, sipas metodave statistikore të përdorura për këtë qëllim. Seritë që mbartin sezonalitet, sipas specifikimeve të testeve statistikore, janë korrigjuar për këtë efekt dhe kanë zëvendësuar seritë ekzistuese të parregulluara për efektin sezonal në kryerjen e analizës mbi aktivitetin kreditues. Pyetësonin e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues së bashku me fjalorin e termave të përdorur në të, një material të shkurtër mbi rëndësinë e këtij vrojtimi, disa aspekte metodologjike, si dhe seritë e përdorura në analizë, i gjeni të publikuara në adresën:

https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues.

PËRMBLEDHJE

Bankat tregtare vlerësuan se mbajtën të pandryshuara standardet për kreditë dhënë bizneseve gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019. Kërkesa për kredi nga ana e bizneseve, sipas opinionit të bankave, ishte më e ulët në tremujorin e dytë, si në segmentin e biznesit të madh ashtu edhe në atë të mesëm e të vogël, e ndikuar nga kreditë me qëllim investimi. Kërkesa për kredi në financimin e nevojave për likuiditet u perceptua më e lartë në tremujorin e dytë. Standardet e kreditimit për individët, në gjykimin e përgjithshëm të bankave, ishin pak më të lehtësuara se një tremujor më parë, si në kreditë konsumatore ashtu edhe në ato për blerjen e banesave. Kërkesa për kredi konsumatore u perceptua më e ulët, ndërkohë që ajo për blerjen e banesave u raportua disi më e lartë.

Standardet e kreditimit vlerësohen të mbeten të pandryshuara për bizneset, ndërkohë që ato për individët priten të lehtësohen disi në tremujorin e tretë të vitit 2019. Kërkesa për kredi e bizneseve në tremujorin e tretë, sipas gjykimin të bankave, pritet të jetë më e ulët, kushtëzuar nga reduktimi i kërkesës për kredi me qëllim investimi. Individët priten të shfaqin një kërkesë më të gjallëruar në tremujorin e tretë, nxitur nga kërkesa më e lartë si për kredi konsumatore ashtu edhe për blerje banesash.


STANDARDET, TERMAT E KREDITIMIT DHE KËRKESA PËR KREDI

1. KREDIA PËR BIZNESE

1.1. Standardet e kreditimit

Sipas opinionit të bankave tregtare, **standardet e kreditimit për bizneset në tërësi mbetën thuajse të pandryshuara** në tremujorin e dytë. Standarde të njëjta kreditimi me një tremujor më parë u raportuan si në kreditë dhënë me qëllim financimin e investimeve, ashtu edhe në ato për plotësim të nevojave për likuiditet nga ana e bizneseve. Në kategorinë e bizneseve të vogla e të mesme, standardet e kreditimit u lehtësuan disi², ndërkohë që për kreditë dhënë bizneseve të mëdha standardet mbetën të pandryshuara. Për tremujorin e tretë, bankat vlerësojnë se nuk do ketë ndryshime në standardet e kreditimit për bizneset, si në aspektin e madhësisë së biznesit, ashtu edhe në atë të qëllimit të përdorimit të kredisë.

Grafik 1. Standardet e kreditimit për bizneset dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm¹




¹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë lehtësim të standardeve, ndërsa ato negative shtrëngim të standardeve. Burimi: Banka e Shqipërisë.

² Standarde disi më të lehtësuara kreditimi për kategorinë e bizneseve të vogla e të mesme u raportuan vetëm nga një bankë e sistemit.

Si faktorë me ndikim pozitiv në lehtësimin e standardeve të kreditimit për bizneset, bankat raportuan shtimin e konkurrencës në sistemin bankar, si dhe kostot dhe kufizimet më të ulëta që burojnë nga pozicioni kapital apo i likuiditetit të bankave. Në kahun shtrëngues të standardeve të kreditimit vepruan faktorët e lidhur me perceptimin e rrezikut nga ana e bankave, që janë: aftësia paguese e kredimarrësit, situata ekonomike dhe perspektiva e saj, si dhe rreziqet lidhur me kolateralin. Po ashtu, edhe toleranca më e ulët e bankave ndaj rrezikut ndikoi në shtrëngimin e standardeve të kreditimit.

Grafik 2. Faktorët me ndikim në standardet e kreditimit për totalin e bizneseve²



²: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësorin e rishikuar në qershor 2018.


Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2. Kushtet dhe termat e kreditimit

Kushtet dhe termat e përgjithshëm mbi kreditë e reja akorduar bizneseve u shtrënguan disi³ nga një tremujor më parë. Shtrëngimi i lehtë i kushteve dhe termave të kreditimit për bizneset u arrit nëpërmjet aplikimit të marzheve disi më të larta mbi kreditë me rrezik, si edhe nëpërmjet shtrëngimit të lehtë të kushteve të tjera joçmim. Këto të fundit u shprehën nga reduktimi i madhësisë së kredisë, si edhe nga rritja e kushtëzimeve në marrëveshjet e kredisë për bizneset. Në kahun lehtësues të kushteve dhe termave të kreditimit u raportuan marzhet më të ulëta mbi kreditë normale.

³ Kushte dhe terma kreditimi disi më të shtrënguara u raportuan vetëm nga një bankë e sistemit, ndërkohë që pjesa tjetër raportoi kushte dhe terma të pandryshuar kreditimi nga një tremujor më parë.


Grafik 3. Ndryshimi i kushteve dhe termave të përgjithshëm në miratimin e kredive të reja për bizneset³



³: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë kushte dhe terma të lehtësuar, ndërsa ato negative të shtrënguar. Burimi: Banka e Shqipërisë. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësonin e rishikuar në qershor 2018.

Faktorët që përcaktuan shtrëngimin e lehtë të kushteve dhe termave të kreditimit ishin të lidhur me kostot më të larta të fondeve dhe kufizimet nga bilanci, si edhe me perceptimin e bankave për rrezik të shtuar.

Grafik 4. Faktorët me ndikim në kushtet dhe termat e kreditimit për totalin e bizneseve⁴




⁴: Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e kushteve dhe termave, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre. *: Ky grafik bazohet mbi një pyetje të re të shtuar në pyetësonin e rishikuar në qershor 2018. Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.3. Kërkesa për kredi

Kërkesa për kredi e bizneseve u perceptua në rënie edhe në tremujorin e dytë të vitit 2019. Kërkesë më e ulët se një tremujor më parë u raportua për kreditë e marra me qëllim investimi, ndërkohë që për ato të përdorura në financimin e nevojave për likuiditet, kërkesa u perceptua më e lartë. Parë në prizmin e madhësisë së biznesit, rënia më e theksuar e kërkesës për kredi u vlerësua nga ana e bizneseve të mëdha.

Grafik 5. Kërkesa aktuale për kredi dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm për bizneset⁵




⁵: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e tretë të vitit 2019, bankat presin një kërkesë më të ulët për kredi nga bizneset, e drejtuar nga pritjet për një kërkesë të dobët të kredisë për investime, ndërkohë që kërkesa për kredi në financimin e nevojave të likuiditetit vlerësohet të mbetet e pandryshuar. Në këndvështrimin e madhësisë së biznesit, pritjet janë për një kërkesë thuhet të pandryshuar për kredi në tremujorin e tretë, si nga bizneset e vogla e të mesme, ashtu edhe nga bizneset e mëdha.

Bankat perceptuan se kërkesa më e ulët për kredi, në tremujorin e dytë të vitit, i atribuohet: nevojave më të ulëta për financimin e investimeve dhe për rifinancimin e borxheve ekzistuese; përdorimit më të lartë të burimeve të brendshme të financimit nga ana e bizneseve; si edhe perceptimit për kushte jo të favorshme të financimit, nxitur kryesisht nga rënia e besimit të biznesit dhe nga situata e perceptuar ekonomike dhe perspektiva e saj. Në kahun rritës të kërkesës për kredi u raportuan kërkesa më e lartë e bizneseve në mbulimin e nevojave për likuiditet, si edhe shtimi i nevojës për financim, si pasojë e ristrukturimit të kompanive.

Grafik 6. Faktorët që ndikuan në ndryshimin e kërkesës për kredi për bizneset⁶




⁶: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka nxitur rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësinë e rishikuar në qershor 2018. Burimi: Banka e Shqipërisë.

2. KREDIA PËR INDIVIDË

2.1. Standardet e kreditimit

Standardet e kreditimit për individët u raportuan disi më të lehtësuara në tremujorin e dytë të vitit 2019. Lehtësimi i standardeve u vërejt si në kreditë për blerje banese, ashtu edhe në ato konsumatore. Lehtësimi i standardeve të kreditimit për individët pritet të vijojë edhe në tremujorin e tretë të vitit, fokusuar kryesisht në segmentin e kredive për blerje banesash.


Grafik 7. Standardet e kreditimit për individët dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm⁷



⁷: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë lehtësim të standardeve, ndërsa ato negative shtrëngim të tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lehtësimi i standardeve të kreditimit ishte pasojë e trysnisë së shtuar që vjen nga konkurrenca në sistemin bankar. Në kahun shtrëngues të standardeve të kreditimit për individët u raportuan kostot dhe kufizimet më të larta që burojnë nga pozicioni i kapitalit të bankave.

Grafik 8. Faktorët me ndikim në standardet e kreditimit për totalin e individëve⁸




⁸: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve, ndërsa ato negative në shtrëngimin e standardeve. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësonin e rishikuar në qershor 2018. Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2. Kushtet dhe termat e kreditimit

Kushtet dhe termat e përgjithshëm për kreditë akorduar individëve u lehtësuan në tremujorin e dytë të vitit, kryesisht në sajë të aplikimit të marzheve më të ulëta mbi kreditë normale. Gjithashtu, edhe kushtet e tjera joçmim u raportuan më të lehtësuara, si pasojë e: kërkesave më të ulëta për kolateral në raport me kredinë e marrë; shtimit të madhësisë së kredisë; si dhe zgjatjes së maturitetit të saj.

Grafik 9. Ndryshimi i kushteve dhe termave të përgjithshme në miratimin e kredive të reja për individët⁹




⁹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë kushte dhe terma të lehtësuar, ndërsa ato negative të shtrënguar.

*: Tregues i ri i shtuar në pyetësonin e rishikuar në qershor 2018.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lehtësimi i kushteve dhe termave të kreditimit, në tremujorin e dytë 2019, ka vijuar të nxitet nga trysnia e shtuar prej konkurrencës në sistemin bankar, si edhe nga reduktimi i kostove të fondeve dhe kufizimeve më të ulëta nga bilanci.

Grafik 10. Faktorët me ndikim në kushtet dhe termat e kreditimit për totalin e individëve¹⁰




¹⁰: Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e kushteve dhe termave, ndërsa ato negative në shtrëngimin e kushteve dhe termave. *: Ky grafik bazohet mbi një pyetje të re të shtuar në pyetësonin e rishikuar në qershor 2018.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3. Kërkesa për kredi

Kërkesa e individëve për kredi u perceptua disi më e lartë në tremujorin e dytë të vitit. Kërkesa për kredi me qëllim blerje banesash u raportua pak më e lartë, ndërkohë që kërkesa për kredi konsumatore u raportua disi më e ulët⁴. Bazuar në opinionin e bankave, kërkesa për kredi e individëve pritet të jetë më e lartë në tremujorin e tretë të vitit 2019, e nxitur nga nevoja më e lartë për financim si të konsumit, ashtu edhe të blerjes së banesave.


Grafik 11. Kërkesa aktuale për kredi dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm për individët¹¹



¹¹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në kahun rritës të kërkesës për kredi nga ana e individëve, sipas gjykimit të bankave, ndikuan nevojat më të larta në financim, si në blerjen e banesave, ashtu edhe për konsum. Ndërkohë, përdorimi më i lartë i burimeve të brendshme të financimit, si edhe shtimi i kredive nga institucionet financiare jobanka, janë raportuar si faktorë që kanë ulur nevojën për financim të individëve nga sistemi bankar.

Grafik 12. Faktorët që ndikuan në ndryshimin e kërkesës për kredi për individët¹²



¹²: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka nxitur rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësinë dhe rishikuar në qershor 2018. Burimi: Banka e Shqipërisë.

⁴ Një bankë e sistemit ishte shprehur për një kërkesë disi më të ulët të kredisë konsumatore, pesha e lartë e së cilës në segmentin e kredisë konsumatore ka bërë që rezultati agregat të jetë negativ, pavarësisht se disa banka të tjera janë shprehur për një rritje të lehtë të kredisë konsumatore.